REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr.64, datë 08/11/2005

"MBI MIRATIMIN E NIVELIT TË ÇMIMEVE DHE TARIFAVE TË SHËRBIMEVE TË DISA INSTITUCIONEVE TË VARËSISË SË BASHKISË SË TIRANËS"

Në mbështetje të ligjit Nr.8652, dt.31/07/2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", neni 16, neni 4 dhe neni 32, gërma "f", ligjit Nr.8982, dt.12/12/2002 "Për sistemin e taksave vendore", neni 23, ligjit Nr.7581, dt.07/07/1992 "Për çmimet dhe tarifat", neni 2 dhe neni 7, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Pushtetit Vendor e Decentralizimit Nr.11, dt.04/02/2003, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike, me propozim të Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I;

1. Të miratojë nivelin e çmimeve dhe tarifave të shërbimit për disa Institucione të Varësisë së Bashkisë së Tiranës, si më poshtë vijon:

Drejtoria e Përgjithshme Nr.1 e Punëtorëve të Qytetit

- Çmimi i biletave në Kopështin Zologjik:

Për fëmijë	50 lekë / bileta
Për të rritur	100 lekë / bileta

Qendra Kulturore "TIRANA"

- Çmimi i biletave për shfaqjet e Cirkut:

Për shfaqjet e organizuara për kopshte e shkolla	Falas
Për shfaqjet e lira për publikun	200 lekë / bileta

- Çmimi i biletave për shfaqjet e Varietesë:

a) Në llozhë	500 lekë / bileta
b) Në aneks llozhë	300 lekë / bileta
c) Në anësore	200 lekë / bileta

- Çmimi i biletave për shfaqjet e Baletit:

a) Në llozhë	700 lekë / bileta
b) Në aneks llozhë	500 lekë / bileta
c) Në anësore	300 lekë / bileta

- Tarifë për dhënie me qera

Dhënia e sallës me qera për një orë 5.000 lekë

Klubi i Futbollit Tirana

- Çmimi i biletës për ndeshje

	Për ndëshje kombëtare	Për ndeshje ndërkombëtare
a) Në anësore	200 lekë / bileta	400 lekë / bileta
b) Përballë	300 lekë / bileta	600 lekë / bileta
c) Në tribunë	500 lekë / bileta	1000 lekë / bileta

- Tarifa për dhënien në përdorim të tretëve të Stadiumit "Selman Stërmasi" për zhvillimin e aktivitetit futbollistik 50.000 lekë / ora

2. Për institucionet kulturore dhe sportive, të ardhurat e krijuara nga çmimet e biletave dhe tarifat e shërbimit, përveç atyre të parashikuara shprehimisht në akte ligjore të veçanta, duke filluar nga viti 2006 të ndahen në këtë mënyrë:

   - 90 % e të ardhurave në favor të Institucionit Kulturor dhe Sportiv
   - 10 % e të ardhurave në buxhetin e Bashkisë së Tiranës

3. Në zbatim të këtij Vendimi, ngarkohet Bashkia e Tiranës për nxjerrjen e Udhëzimeve të mëtejshme për shpërndarjen e të ardhurave të Institucioneve të Varësisë, sipas pikës 2 të këtij Vendimi.

4. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

LUAN SHAHOLLARI